

**Njoftim për përqendrim me të cilin ORBICO SHPK për tregti Zagreb, Republika e Kroacisë do të fitojë kontrollin mbi PROFESHNAL SAPORT s.r.o., Republika Çeke (Lënda nr. 08-127/2026)**

Në përputhje me nenin 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 145/10, 136/11, 41/14, 53/16, 83/18 dhe “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 208/24 dhe 16/25), më datë 26.08.2026, pranë Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës është dorëzuar njoftim për përqendrimin me të cilin ORBICO SHPK për tregti Zagreb, me seli në rr. Koturaška Cesta 69, Zagreb, Republika e Kroacisë, do të fitojë kontroll të vetëm mbi PROFESHNAL SAPORT s.r.o., me seli në Voriškova 402/11, Kohoutovice, 623 00 Brno, Republika Çeke, përmes shitblerjes së pjesëve.

**Pjesëmarrësit në përqendrim dhe aktivitetet e tyre afariste:**

Lënda e veprimtarisë së ORBICO SHPK për tregti Zagreb është tregtia me shumicë.

ORBICO SHPK për tregti Zagreb është e pranishme në Republikën e Maqedonisë së Veriut përmes shoqërisë së saj të varur Shoqëria për tregti dhe shërbime ORBICO SHPK Shkup, me seli në rrugën “Boris Trajkovski” nr. 286, Komuna Kisella Vodë, 1000 Shkup, Republika e Maqedonisë së Veriut, me veprimtari parësore: 46.900 - Tregti me shumicë e paspecializuar.

Lënda e veprimtarisë së PROFESHNAL SAPORT s.r.o. është tregtia me shumicë dhe pakicë me produkte profesionale për pastrim (kimi industriale dhe teknike).

Me transaksionin e propozuar, ORBICO SHPK për tregti Zagreb fiton kontroll të drejtpërdrejtë mbi PROFESHNAL SAPORT s.r.o., dhe me këtë kontroll të tërthortë edhe mbi shoqëritë e saj të varura, edhe atë:

(1) PROFESHNAL SAPORT s.r.o., me seli në Sv. Shtefana 5, Shturovo, Sllovaki, lënda e veprimtarisë – tregtia me shumicë dhe pakicë me produkte profesionale për pastrim (kimi industriale dhe teknike); dhe

(2) PROFESHNAL SAPORT Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, me seli në rrugën Arok nr. 3, 2500 Estergom, Hungari, lënda e veprimtarisë – tregtia me shumicë dhe pakicë me produkte profesionale për pastrim (kimi industriale dhe teknike).

Përveç shoqërive të varura të përmendura këtu, PROFESHNAL SAPORT s.r.o. nuk ka shoqëri të tjera të varura, nuk është e pranishme në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe nuk realizon të ardhura në Republikën e Maqedonisë së Veriut, ndërsa shoqëritë e saj të varura të përmendura më sipër nuk kanë shoqëri të tjera të varura, nuk janë të pranishme në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe nuk realizojnë të ardhura në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Për nevojat e vlerësimit të përqendrimit në fjalë, parashtruesi i njoftimit propozon që tregu përkatës të definohet si treg për tregtinë me shumicë dhe pakicë me produkte profesionale për pastrim (kimi industriale dhe teknike) në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

*Në bazë të shqyrtimit paraprak, Komisioni konstatoi se përqendrimi në fjalë mund të bjerë nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës. Megjithatë, vendimi përfundimtar lidhur me këtë çështje mbetet i rezervuar.*

*Komisioni i fton palët e treta të interesuara që t'i dorëzojnë vërejtjet dhe mendimet e tyre lidhur me këtë përqendrim Komisionit. Vërejtjet dhe mendimet e palëve të treta të interesuara mund të dërgohen në adresën: rr. „Shën Kirili dhe Metodi“ nr. 54, Shkup, ose me e-mail: kzk@kzk.gov.mk, dhe të njëjtat duhet të arrijnë në Komision brenda afatit prej 10 ditësh nga dita e publikimit të këtij njoftimi*

01.09.2026

Shkup